



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr. 4677 Prot.

Tiranë , më 14.10.2015

URDHËR

Nr.435 datë 14.10.2015

PËR

**MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË HAPAVE TRATEGJIKE PËR MENAXHIMIN E
SIGURTË TË MBETJEVE RADIOAKTIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe bazuar në ligjin Nr.8025,datë 9.11.1995,“ Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese ”,i ndryshuar ;

URDHËROJ:

1. Miratimin e dokumentit të “ Hapave strategjike për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë ”.

2. Ngarkohet Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet për zbatimin e këtij urdhri .

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ILIR BEQAJ

**HAPAT STRATEGJIKË PËR MENAXHIMIN E
SIGURTË TË MBETJEVE RADIOAKTIVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

PËRMBAJTJE

1. Objektivi i Strategjisë Kombëtare
2. Qëllimi i Strategjisë Kombëtare
3. Elementë të Strategjisë Kombëtare
4. Klasifikimi i mbetjeve
5. Strategjia Optimale
6. Karakterizimi i mbetjeve radioaktive
7. Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar
8. Strategjia Optimale IFBZ
9. Burimet e humbura
10. Infrastruktura e menaxhimit të burimeve të konsumuar si dhe mbetjeve radioaktive.
11. Kërkesat për zhvillimin e një infrastrukture afat shkurtër (në) dhe afat mesëm për realizimin e strategjisë
12. Sistemi i trajnimit për rregullatorët, punonjësit dhe përdoruesit
13. Sistemi i menaxhimit të cilësisë
14. Implementimi i Strategjisë
15. Plani i Veprimit

LISTA E AKRONIMEVE

BE	Bashkimi European
ANEA	Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike
KMR	Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet
IFBZ	Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar

HYRJE

Kontrulli i burimeve radioaktive ka qenë dhe është në fokus të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Për këtë janë miratuar një sërë ligjesh dhe rregulloresh për përdorim të sigurtë të burimeve radioaktive në Shqipëri. Në këtë kuadër një vend të rëndësishëm zë menaxhimi i sigurt i mbetjeve radioaktive në Shqipëri. Me qëllim sigurimin e tanishëm dhe të brezave të ardhshëm KMR ka përgatitur këtë strategji në bashkëpunim me Institutin e Fizikës Bërthamore si institucioni i cili është përgjegjës për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive duke siguruar njëkohsisht mbrojtjen e publikut dhe mjedisit. Meqënëse depoja e ruajtjes së perkohshme të burimeve radioaktive të licencuar nga ana e KMR tashmë ndodhet në ambiente publike, kjo është një arsye më shumë përse KMR përgatiti këtë strategji afatgjatë për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive duke përfshirë dhe depon përfundimtare. Kjo strategji merr në konsideratë zhvillimet e fundit në këtë fushë si dhe depozimin e tyre në formë përfundimtare, e cila zgjidh përfundimisht trajtimin e mbetjeve radioaktive. Kjo strategji lë të hapur dy opsione për trajtimin e mbetjeve, të cilat do të studiohen më tej nga ana e IFBZ se cila mënyrë është më e përshtatshme për trajtimin përfundimtar të mbetjeve radioaktive në Shqipëri duke marrë në konsideratë sigurinë dhe kostot.

1. Objektivi i strategjisë kombëtare

Strategjia kombëtare për menaxhimin e burimeve të konsumuara dhe menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive ka si objektiv përshkrimin e aktiviteteve dhe përcaktimin e përgjegjësisë, të cilat do të lejojnë të arrihen të gjitha synimet e përcaktuara në dokumentin Nr. 1319/3 datë 25.03.2013 për Politikën e menaxhimit të mbetjeve radioaktive miratuar nga KMR. Gjithashtu objektivi i strategjisë kombëtare është të sigurojë zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi koherent, të integruar, të optimizuar dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e të gjithë llojeve të burimeve radioaktive që nuk përdoren si dhe mbetjeve radioaktive që prodhohen në Shqipëri. Strategjia kombëtare gjithashtu kërkon implementim në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit dhe rregulloreve mbi sigurinë, sigurimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Elementet legislative që nuk janë në përputhje me këtë strategji duhet të ndryshohen.

2. Qëllimi i strategjisë kombëtare

Qëllimi i përgatitjes së kësaj strategjie është që të sigurojë një menaxhim të sigurtë të burimeve të konsumuara si dhe mbetjeve radioaktive në vend, në të gjithë fazat nga ruajtja deri në depozitimin përfundimtar, duke siguruar një mbrojtje të publikut si dhe brezave të ardhshëm dhe duke mbrojtur ambientin.

3. Elementë të strategjisë kombëtare

Inventari i regjistrit kombëtar të burimeve të konsumuar si dhe mbetjeve radioaktive

Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar mban të dhënat për burimet e konsumuar si dhe mbetjet radioaktive. Këto të dhëna përfshijnë institucionin nga i cili janë prodhuar këto mbetje, lloji dhe

sasia, si dhe karakteristikat e tyre fizike, kimike dhe radiologjike. Gjithashtu inventari duhet të përfshijë dhe nëse këto burime janë të kondicionuara, janë në ruajtje të përkohshme, perioden e përgjysmimit dhe çlirimit kur janë në nivelet e çlirimit. Në rastin kur burimet janë ende në përdorim, i gjithë informacioni mbahet nga përdoruesi dhe i vihet në dispozicion Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, i cili në bazë të këtij informacioni krijon regjistrin kombëtar të burimeve radioaktive, të cilat janë në përdorim. Një kopje të inventarit të mbetjeve IFBZ e paraqet në KMR.

Institucionet që prodhojnë mbetje radioaktive duhet t'i vënë në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm, Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, i cili konsolidon inventarin kombëtar të të gjithë burimeve të konsumuar, si dhe mbetjet radioaktive të prodhuara në vend, që nga origjina e tyre, lloji dhe sasia, karakteristikat deri në vlerësimin e situatës në të ardhmen.

4. Klasifikimi i mbetjeve

Skema e klasifikimit të mbetjeve siguron një strukturë shumë të përdorshme për menaxhimin e mbetjeve radioaktive duke treguar në përgjithësi, alternativën më të përshtatshme për menaxhimin e tyre për një kohë të gjatë. Rekomandimet e ANEA-s për skemën bazohen mbi aktivitetin specifik dhe periudhën e përgjysmimit. Skema e mëposhtme është e thjeshtë për t'u aplikuar dhe merr në konsideratë sigurinë e mbrojtjes nga rrezatimet. Skema jep një afrim sasior për vlerat aktuale të aktivitetit specifik dhe periudhës së përgjysmimit duke i ndarë mbetjet në klasa të ndryshme. Skema e mëposhtme gjithashtu jep dhe opsionet e mundëshme në lidhje me trajtimin e mbetjeve deri në depon përfundimtare.

Sistemi i klasifikimit të mbetjeve në Shqipëri

Periudha e përgjysmimit	Aktiviteti në Bq	Opsioni i preferuar		Opsioni Alternativ	
		Përpunimi	Hapi final	Përpunimi	Hapi final
<100ditë	(All)	Zbërthimi	Clirimi nga kontrolli rregullator	Kondicionim i mbetjeve në një paketim standart	Vendosja në Depo përfundimtare në sipërfaqe
>100ditë <30vjet	<10 ⁶	Kondicionim i mbetjeve në një paketim standart	Vendosja në Depo përfundimtare në sipërfaqe	Paketimi për transport	Kthimi tek furnizuesi
>100ditë <30vjet	>10 ⁶	Paketimi për transport	Kthimi tek furnizuesi	Kondicionim i mbetjeve në një paketim special	Vendosja në Depo përfundimtare në thellësi të tokës
>30vjet	<10 ³	Kondicionim i mbetjeve në një paketim standart	Vendosja në Depo përfundimtare në sipërfaqe	Paketimi për transport	Kthimi tek furnizuesi
>30vjet	>10 ³	Paketimi për transport	Kthimi tek furnizuesi	Kondicionim i mbetjeve në një paketim special	Vendosja në Depo përfundimtare në thellësi të tokës

5. Strategjia Optimale

KMR përgatit rregulloren për menaxhimin e burimeve të konsumuar, si dhe mbetjeve radioaktive, duke marrë në konsideratë klasifikimin e mbetjeve të përcaktuara në tabelën e mësipërme. Nivelet e përjashtimit /çlirimit do të përcaktohen në rregullore, në përputhje me vlerat e rekomanduara nga ANEA-s, si dhe standardet bazë të sigurisë.

6. Karakterizimi i mbetjeve radioaktive

Menaxhimi i sigurtë i burimeve të konsumuar, si dhe mbetjeve radioaktive, varet nga karakteristikat e tyre. Karakterizimi i tyre ka si qëllim të përcaktojë llojin dhe sasinë e mbetjeve radioaktive që do të pranohen si dhe hapat e njëpasnjëshme të menaxhimit të tyre, duke përfshirë transportin, magazinimin si dhe për të përmbushur kriteret e pranimi të mbetjeve radioaktive në depon përfundimtare.

Demonstrimi i një regjimi të përshtatshëm karakterizimi ndihmohet nga (aplikimi dhe) zbatimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë për çdo burim, ku të dhënat të jenë të besueshme, të

lexueshme dhe të dukshme. Sistemi i menaxhimit të cilësisë gjithashtu do të përfshijë trajnimin, metodën e zhvillimit, kualifikimin dhe dokumentacionin. Përcaktimi i depos përfundimtare është i nevojshëm për të qënë në linjë edhe me politikat e sigurisë, si për publikun ashtu dhe për mjedisin.

7. Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar

Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar duhet të përcaktojë procedura për karakterizimin e burimeve të konsumuara, si dhe mbetjet radioaktive. Përdoruesit duhet të paraqesin dokumentacionin mbi burimin radioaktiv në KMR. Ndërsa IFBZ duhet të paraqesë në KMR informacionin në momentin e transferimit të mbetjeve në depo. IFBZ duhet të kontrollojë dokumentacionin nëse është në përputhje me rezultatin e karakterizimit. IFBZ është përgjegjës për karakterizimin e burimeve jetime në momentin kur ato gjenden. KMR duhet të sigurojë që ky karakterizim është bërë në përputhje me licensën që IFBZ disponon. IFBZ përcakton edhe kriteret e pranimit të burimeve në depo nëpërmjet një rregulloreje të veçantë.

Për një menaxhim të sigurtë të mbetjeve radioaktive duhet të merren në konsideratë në çdo hap Ligji nr.10 379 datë 24.2.2011, për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e bashkuar Për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive si dhe direktiva e BE 2011/70/Euratom, 19 korrik 2011, për menaxhimin e sigurtë të lëndës djegëse të konsumuar dhe mbetjeve radioaktive.

8. Strategjia Optimale IFBZ

Të gjitha burimet e konsumuara, si dhe mbetjet radioaktive duhet të karakterizohen para se të pranohen në ruajtje apo në depon përfundimtare. Prioritet duhet t'i jepet (reduktimit) zvogëlimit të vëllimit të mbetjeve radioaktive, të cilat kanë nevojë për një menaxhim afatgjatë (në Shqipëri). Për të lehtësuar këtë process, KMR (aplikon dhe) zbaton Kodin e Drejtimit mbi sigurinë dhe sigurimin e të gjitha burimeve radioaktive të importuara në vend dhe udhëzuesit shtesë të tij. Në zbatim të kësaj, do të kërkohet që importuesit e burimeve radioaktive të sigurojnë kthimin e tyre tek prodhuesi ose në një depo jashtë vendit. Burimet e konsumuara të cilat nuk përpunohen (dot) nga ana e IFBZ duhet të eksportohen (jashtë vendit).

IFBZ mbetet qendra kryesore e grumbullimit dhe trajtimit të burimeve të papërdorshëm, konsumuar ose mbetjeve radioaktive në vend.

IFBZ do të vlerësojë opsionet teknike të përshtatshme për depon përfundimtare në lidhje me burimet radioaktive ekzistuese në vend. IFBZ duhet të bëjë një studim lidhur me variantin më të mirë për depon përfundimtare të burimeve radioaktive. Eksporti i burimeve radioaktive që përfshihen nga kategoria 1 deri në 2, si dhe radionuklidet jetëgjatë, është një nga zgjedhjet e mundëshme që duhet të vlerësohet nga IFBZ. IFBZ do të shohë dhe studiojë gjithashtu fizibilitetin në lidhje me përcaktimin e depos përfundimtare, e cila mund të jetë në sipërfaqe të

tokës e ndërtuar sipas parametrave të kërkuar ose një depo përfundimtare në thellësi të tokës për të gjitha tipet e burimeve dhe mbetjeve radioaktive.

IFBZ do të mbetet qendra kombëtare për përpunimin e mbetjeve radioaktive dhe përcaktimin e variantit të depos përfundimtare në vend.

9. Burimet e humbura

IFBZ kryen përpunimin e burimeve jetime në vend.

Portalet e dedektimit të rrezatimit që janë instaluar në pikat doganore monitorohen nga autoritetet kompetente në pikat doganore ose aty ku janë instaluar. Ndërsa për portalet e instaluar tek kompanitë private (p.sh kompanitë e skrapit) këto kompani janë përgjegjëse për monitorimin e tyre. Autoritetet kompetente do të mirëmbajnë dhe kur të jetë e nevojshme të përmirësojnë sistemin ekzistues dedektues në pikat doganore, lidhur me sigurinë e publikut dhe punonjësve. Portalet e instaluar tek kompanitë private do të operohen nga vetë pronarët e kompanive. Të gjithë portal monitorët të rregullohen për veprimatarinë e tyre nga ana e KMR. Si reaguesi i parë në rastin e dedektimit të një ngjarjeje, IFBZ do të jetë përgjegjës për menaxhimin e mëtejshëm të burimeve të gjetura të cilat do të transportohen në qendrën e menaxhimit dhe përpunimit të mbetjeve radioaktive në përputhje me planin e emergjencave.

10. Infrastruktura e menaxhimit të burimeve të konsumuar si dhe mbetjeve radioaktive.

10.1 Statusi Aktual

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet në zbatim të ligjit Nr. 8025, datë 9.11.1995 Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese i ndryshuar, është i pavarur dhe raporton në qeveri nëpërmjet Ministrit të Shëndetësisë. IFBZ është ligjërisht përgjegjëse për menaxhimin e burimeve të konsumuar, të papërdorshëm si dhe mbetjeve radioaktive, nëpërmjet qendrës së menaxhimit të mbetjeve.

10.2 Standardet Ndërkombëtare

Standardet e siguri të ANEA-s kërkojnë që KMR të jetë i pavarur nga institucionet operuese. Standardet Ndërkombëtare, kërkojnë që KMR të aplikojë të gjitha procedurat regullatore, siç janë: licensimi, inspektimi dhe sanksionet, për një siguri dhe sigurim të mbetjeve radioaktive në vend. KMR duhet të vendosë dhe të implementojë kërkesat përkatëse nëpërmjet rregulloreve dhe udhëzuesve. Qeveria siguron burime financiare dhe njerëzore për KMR dhe siguron që legjislacioni i jep atij të drejtën të licencojë, të inspektojë dhe të zbatojë rregulloret që lidhen me aktivitete për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive.

Qeveria është përgjegjëse për të siguruar mekanizmat e nevojshme që menaxhimi i mbetjeve radioaktive të zbatohet në mënyrë të sigurtë dhe efikase. Nëpërmjet rregulloreve përcaktohen siguria, sigurimi si dhe nxitja e një kulture të siguri dhe të sigurimit. Efikasiteti sigurohet përmes një financimi adekuat dhe funksionimi sa më të mirë të IFBZ, duke përcaktuar në

mënyrë të qartë, përgjegjësinë, trajnimin e duhur dhe një sistem monitorimi të performancës. Qeveria siguron një mekanizëm të aftë financimi për IFBZ. IFBZ përcakton kostot reale të shërbimeve.

11. Kërkesat për zhvillimin e një infrastrukture afatshkurtër në afatmesëm për realizimin e strategjisë.

IFBZ do të vazhdojë të përmirësojë dhe zgjerojë mundësitë për qendrën ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve radioaktive, në veçanti me procesin e trajtimit të mbetjeve, ruajtjes së përkohëshme dhe për dërgimin në depon përfundimtare të të gjitha mbetjeve radioaktive të prodhuara në vend, të cilat nuk mund të kthehen tek prodhuesi ose që janë të përjashtuara nga kontrolli rregullator. KMR do të monitorojë dhe vlerësojë përshtatshmërinë e sistemit ekzistues kombëtar për zbulimin e burimeve jetimë. Kur është e nevojshme, KMR do të bëjë rekomandime për përmirësim.

IFBZ do të hetojë mundësitë për sigurinë dhe sigurimin e depos përfundimtare për të gjitha burimet radioaktive që do të konsiderohen si mbetje në vend ose do të shikojë mundësinë e dërgimit të disa burimeve të fuqishme dhe me periudë të madhe përgjysmimi jashtë vendit.

Në plotësimin e dokumentacionit për marrjen e licensës për depon përfundimtare është e rëndësishme të paraqitet dhe vlerësimi strategjik mjedisor në lidhje me impaktin e depos përfundimtare në mjedis.

Në të ardhmen, zhvillimi i depos përfundimtare do të lejojë që mbetjet radioaktive të vendosura në Qendrën e Menaxhimit të Mbetjeve të hiqen përgjithmonë.

12. Sistemi i trajnimit për rregullatorët, punonjësit dhe përdoruesit.

IFBZ do të bashkëpunojë me ANEA-n për të zhvilluar dhe zbatuar një sistem sistematik dhe gjithëpërfshirës të trajnimit dhe kualifikimit të stafit të saj. Kjo do të bazohet në praktikat më të mira ndërkombëtare, për rregullimin e veprimtarive bërthamore në përgjithësi dhe, në veçanti, për menaxhimin e mbetjeve radioaktive. KMR miraton sistemin e trajnimit. Përdoruesit/ pronarët e materialeve radioaktive duhet të sigurojnë se personat të cilët janë të angazhuar në punë me këto burime, kanë eksperiencën dhe kualifikimin e duhur (mbi) për sigurinë nga rrezatimi.

Sikurse shprehet në politikat kombëtare të menaxhimit të mbetjeve radioaktive të gjitha çështjet që lidhen me burimet e konsumuara dhe mbetjet radioaktive do të jenë të hapura dhe transparente. KMR siguron që publiku do të informohet menjëherë për ndonjë ndikim potencial ose real në shëndetin dhe sigurinë e publikut dhe mjedisit, që mund të vijë nga menaxhimi i burimeve të konsumuara dhe mbetjeve radioaktive si dhe nga ndonjë incident i mundshëm.

13. Sistemi i menaxhimit të cilësisë.

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe IFBZ do të zhvillojë dhe implemetojë një sistem të përshtatshëm të menaxhimit të cilësisë, për të lehtësuar planifikimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjitha aspekteve. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet vlerësimit të sigurisë dhe sigurimit.

14. Implementimi) Zbatimi i Strategjisë

Institucioni përgjegjës për implementimin e Strategjisë për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive është IFBZ. KMR është përgjegjëse për të gjitha aspektet regullatore për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive.

Bazuar në Planin e veprimit, Qeveria duhet të marrë një vendim për të ecur përpara për përcaktimin e depos përfundimtare të mbetjeve ose eksportimin e tyre jashtë vendit.

Plani i veprimit

Masa prioritare 1a : Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë European, në vecanti rishikimi i rregullores për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive, e cila do të përafrohet me direktivën e BE 2011/70/Euratom, 19 Korrik 2011, për menaxhimin e sigurtë të lëndës djegëse dhe mbetjeve radioaktive.	Afatet për implementimin	Institucionet përgjegjëse
<i>Qëllimi strategjik:</i> Plotësimi i kërkesave të strategjisë si dhe plotësimi i detyrimeve në zbatim të Ligjit Nr. 10 379 ,datë 24.2.2011,për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e bashkuar Për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive, si dhe dokumentit të ANEA-s, Kodit të Drejtimit.		
Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet do të rishikojë rregulloren për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në përputhje me direktivën e BE 2011/70/Euratom, 19 Korrik 2011.	2020	MSH / KMR
Masa Prioritare 1b : Studimi i fisibilitetit		
<i>Qëllimi strategjik:</i> Gjetja e një alternative të mundshme për Shqipërinë si depo përfundimtare		
Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar duhet të fillojë studimin (mbi) për fisibilitet në lidhje me përcaktimin e depos përfundimtare, e cila mund të jetë në sipërfaqe të tokës e ndërtuar sipas parametrave të kërkuar, ose në thellësi të tokës për të gjitha tipet e burimeve dhe mbetjeve radioaktive.	2020	IFBZ
Masa Prioritare 1 c: Selektimi i vendit		
<i>Qëllimi strategjik :</i> Përcaktimi i variantit më të mirë për depon përfundimtare		
Qeveria duhet të vëndosë për variantin e depos përfundimtare mbi bazën e studimit të fizibilitetit Të bëhet vlerësimi strategjik Mjedisor Selektimi i	2025	IFBZ dhe ministrinë e

vendit do të bëhet nga IFBZ ne bashkëpunim me institucionet e linjës		linjës
Masa Prioritare 1 d : Studimi për sigurinë e depos përfundimtare të mbetjeve radioaktive.		
<i>Qllimi strategjik :</i> Përgatitja e studimit në lidhje me sigurinë dhe sigurimin e mbetjeve radioaktive.		
Studimi për sigurinë e depos përfundimtare do të përgatitet nga IFBZ,pasi qeveria të ketë vendosur për vendin e depos përfundimtare,sipas vlerësimeve të dhena nga ana e IFBZ në bashkëpunim me institucionet e linjës në këtë fushë.	2030	IFBZ
Masa Prioritare 1 e : Aplikimi për Liçensë		
<i>Qëllimi strategjik :</i> Licensimi i depos së mbetjeve		
Pas aplikimit për licensë dhe miratimit të licensës nga trupa rregullatore do të fillojë ndërtimi i depos përfundimtare.	2030	IFBZ